



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1072/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić Kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi, anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Drilon Brahimi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1072/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Drilon Brahimi, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në qendrat e votimit 1920X, 1921X, 1920E, 1921E dhe 1926E.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Drilon Brahimi, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Prishtinë, në të cilën thekson se gjatë numërimit të votave në qendrat e votimit 1920X, 1921X, 1920E, 1921E dhe 1926E dyshon se i është shtrembëruar rezultati dhe duke pretenduar se i mungojnë votat e familjarëve dhe të miqve të tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar ndonjë provë bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli nuk mund të konstatoj se ka pasur mungesë të votave për kandidatin në fjalë, për faktin se thëniet e tij janë vetëm theksime dhe supozime në apel të cilat si të tilla ato pretendime nuk janë të konkretizuara dhe nuk janë të mbështetura me asnjë provë konkrete bindëse për atë çfarë ai pretendon.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Drilon Brahimi, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Prishtinë, nuk është i bazuar me asnjë provë apo dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi në qendrat e votimeve të lartcekura.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1072/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Panelit

Milena Đerić



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.